

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-22-0633*****Në ankesën e******Paditësja*****E Z** nga fshati B, Komuna e Kaçanikut.***Kundër******E paditura/Ankuesja*****N.T.SH "Sharr" (në likuidim)** Kaçanik, të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6956 të datës 26 tetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-6956 i datës 26 tetor 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Me 17 tetor 2013, paditësi tek Autoritetit të Likuidimit (AL) kishte parashtruar kërkesa kreditore për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën korrik 2010- Korrik 2012 dhe për muajin maj 2013, në shumë prej 2,871.00 euro nga N.T.SH "Sharr".

Me 08 tetor 2014, Autoritetit të Likuidimit (AL) me vendimin GJI105-0150 datës 08 tetor 2014, e kishte pranuar si të bazuar paditësit pagën e muajit maj 2013 në shumë prej 241.23 euro (neto) dhe 32.82 euro në emër të tatimit të ardhurave personal, ndërsa pjesa tjetër për periudhën e pagave të pa paguara korrik 2010- Korrik 2012 në shumë prej 2,610.00 euro është refuzuara me arsyetim se kërkesa është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar.

Më 07 nëntor 2014, paditësi ka parashtruar pranë DHPGJS-së ankesë kundër Autoritetit të Likuidimit (AL) GJI105-0150 të datës 08 tetor 2014 me të cilën ishte refuzuar kërkesa kreditore për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën korrik 2010- Korrik 2012 nga N.T.SH "Sharr". Paditësi në padinë e parashtruar ka propozuar që të ndryshohet vendimi i lëshuar nga Autoriteti i Likuidimit dhe t'i njohët e drejta në pagat e pa paguara edhe për një shumë shtesë prej 2,610.00 euro. Paditësi së bashku me ankesë ka bashkangjitur këto prova si në vijim: Vendimin e AL-së, me shenjën GJI105-0150 i datës 08 tetor 2014, Listat e pagave për muajt korrik 2010, shtator 2010, nëntor 2010, janar 2011, mars 2011, maj 2011, janar 2012, mars 2012, maj 2012 dhe korrik 2012, të lëshuar nga NSH "Sharr", me seli në Kaçanik, Akti Noterial (Deklarata nën Betim)LRP.nr.2972/2013, i datës 06 dhjetor 2013.

Me 26 janar 2017, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. AKP-ja është deklaruar se paditësi nuk ka sqaruar se cila dispozitë ligjore është shkelur, po ashtu AKP-ja ka ngritur edhe prapësimin e parashkrimit të kërkesës, duke theksuar se me nenin 608 të Ligjit për Punën e bashkuar është përcaktuar se kompensimi i pagës apo çdo lloj tjetër kërkesë e punëtorit që buron nga

marrëdhënia e punës, do të parashkruhet për tri vjet. Po ashtu, përgjigja në padi i referohet nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, ku është përcaktuar se kërkesat apo pretendimet e pas afatshme, sipas kufizimeve kohore të aplikueshme, do të refuzohen si të pa baza. Andaj AKP-ja me përgjigjen e parashtruar ka propozuar që të hedhet poshtë padia apo të refuzohet kërkesëpadia, si dhe të vërtetohet vendimi i lëshuar nga AL-ja.

Me 26 tetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-6956, në piken 1 ka Miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadia e paditësit E Z dhe e ka ndryshuar vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit-Autoritetit të Likuidimit, ashtu që ka detyruar të paditurën Agjencia Kosovare e Privatizimit që paditësit t'ia paguajë shumën prej 2,740.50 euro në emër të kompensimit për 10 paga të mbetura të pa paguara përgjatë periudhës Shtator 2010-Korrik 2012 dhe për një pagë të muajit Maj të vitit 2013. Në pikën 2 ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, në pjesën tjetër të saj, respektivisht mbi shumën e aprovuar me aktgjykim prej 2,740.50 euro, e deri në shumën e kërkuar prej 2,871.00 euro, ndërsa në piken 3 është vendosur se shumat e miratuara do të përmbushen në pajtim me prioritet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit. Në piken 4 është vendosur që secila pala ti bart shpenzimet e veta. Shkalla e I-rë, e DHPGJS ka konstatuar se nuk është kontestues fakti se paditësi ishte punëtor i NSH "Sharri ", deri me fillimin e procedurës së likuidimit të sajë, ku kishte një pagë neto prej 241.20 euro në muaj. Paditësi kishte paraqitur kërkesë kreditore pranë AL-së, për pagesën e pagave të mbetura të pa paguara që i takojnë periudhës korrik 2010- korrik 2012 dhe për një pagë të muajit Maj të vitit 2013. Autoriteti i Likuidimit i'a kishte aprovuar kërkesën kreditore vetëm për pagën e fundit - për muajin Maj 2013 ,në shumën prej 241.23 euro (neto) dhe në shumën prej 32.82 euro (tatim në të ardhura personale), ndërsa kërkesën për pagat e tjera ia ka refuzuar. Shkalla e I-rë ka theksuar se e AKP-ja nuk e ka kontestuar periudhën për të cilën janë kërkuar pagat e as lartësinë e tyre. Madje me njohjen e të drejtës në pagë, ka konfirmuar se lartësia e pagës është siç kërkohet nga pala paditëse dhe siç është mbështetur vendimi i AL-së, ka qenë parashkrimi i kërkesës kreditore.

Shkalla e I-rë, ka konstatuar se kërkesa e paditësit nuk është parashkruar kjo ngase paditësi e ka paraqitur kërkesën kreditore pranë AL me datën 17 Tetor 2013, për paga të pa paguara që i referohen periudhës korrik 2010-korrik 2012. Kërkesa kreditore e ka ndërprerë afatin e parashkrimit për tri vjet e fundit, respektivisht për pagat që i takojnë periudhës shtator 2010 e më tutje. Përrjashtimisht paga e muajit korrik 2010, është parashkruar, sepse ajo pagë është dashur të jepet më së largu në muajin gusht të vitit 2013, respektivisht rreth dy muaj para se të parashtrohej kërkesa kreditore në procedurë të likuidimit.

Shkalla e I-rë ka kishte konstatuar se duke u mbështetur në nenin 369 të LMD-së, ku është përcaktuar se ' Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës' 'pra, me paraqitjen e kërkesës kreditore pranë AL si autoritet kompetent për shqyrtimin e saj, është ndërprerë afati i parashkrimit. Shkalla e I-rë kishte arritur në përfundim se nuk janë parashkruar detyrimet e të paditurës përkitazi më 9 paga të palës paditëse, dhe atë për muajt: Shtator 2010, nëntor 2010, janar 2011, mars 2011, maj 2011, janar 2012, mars 2012, maj 2012, korrik 2012. Ndërsa paga e muajit Maj 2013 është pranuar edhe me vendimin e AL-së. Shkalla e I-rë ka konstatuar se për këto 10 paga mujore, rezulton shuma prej 2,412.30 euro si për paga neto(10 muaj x 241.23 euro) dhe shuma prej 328,20 euro si tatim në të ardhura personale (10 muaj x 32.82 euro), që në total bëjnë 2,740.50 euro.

Ndërsa lidhur me pagën e muajit korrik të vitit 2010, për të cilën gjykata ka gjetur se është parashkruar, paditësi nuk ka paraqitur apo prezantuar ndonjë ngjarje juridike (veprim ligjor, padi, deklaratë e pohimit të borxhit), që do të shkaktonte ndërprerjen e afatit të parashkrimit. Paditësi i është referuar aktit noterial-deklaratës nën betim të dhënë nga M D, mirëpo nga përmbajtja e saj shihet se është një deklaratë e përgjithshme dhe që pohon detyrimin konkret, dhe rrjedhimisht nuk i plotëson kriteret e nenit 368 dhe 369 të LMD-së, që rregullon ndërprerjen e aftit të parashkrimit. Për arsyet e lartpërmendura gjykata e ka

konsideruar si kërkesë të parashkruar, kërkesën për pagën e muajit Korrik të vitit 2010 dhe nuk e ka njohur me këtë aktgjykim.

Më 15 nëntor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktvendim Korrigjues që aktgjykimi i kësaj gjykate me numë C-IV-14-6956, i datës 26 tetor 2022, ashtu që në dispozitivin e aktgjykimit, paragrafi 1, në vend të "PRN125-0399 i datës 05.09.2014", shënohet "GJI1105-0150, i datës 08 tetor 2014".

Me 17 nëntor 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-6956 të datës 26 tetor 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit, të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, duke e refuzuar ankesën ndaj Vendimit të AL-së si të pa bazuar dhe vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja në ankesën e parashtruar thekson se Shkalla e I-re në rastin konkret ka konstatuar se paditësi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve pranë AL më 17 tetor 2013 , përmes të cilës kërkoi kompensimin për paga të pa paguara në shumën prej 2,871.00 euro për periudhën korrik 2010 deri në korrik 2012 edhe për, Muajin maj 2013. Për më tepër në ankesë AKP-ja pohon se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Autoriteti i Likuidimit thekson se janë dy afate të ndryshme, ai për parashtrimin e ankesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e Likuidimit dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat e të drejtës) që referohet parashkrimit të kërkesës në afatin prej 3 viteve. Tutje AKP-ja pohon se njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës së cilës i referohet Gjykata e njofton paditësin për të drejtën që të parashtrrojë kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit, ky njoftim nuk i mbron të drejtat dhe as nuk jep mjete ligjore për paditësin. Tutje AKP-ja ende konsideron se kërkesa për paga të pretenduara nga paditësi janë parashkruara në bazë të Nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar pasi që paditësi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi të ketë kërkuara këto paga brenda 3 viteve.

AKP-ja në ankesë e parashtruar ka theksuar se parashtruesit i është shqyrtuar kërkesa nga Autoriteti i Likuidimit dhe në fund të procesit të shqyrtimit është

konstatuar se ajo është parashkruar. Në këtë rast afati i parashkrimit ka filluar të llogaritet nga momenti kur parashtruesi nuk ka pranuar me paga nga NSH-ja. Ai moment është gushti i vitit 2003. Pra parashtruesi është dashur të paraqitet më se voni deri në Gusht të vitit 2006. Në këtë kuptim momenti kur parashtruesit i është dërguar njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e drejta e realizmit për paga të pa paguara veç se ka qenë e parashkruar duke u bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së dhe nenit 608 të Ligjit për punë të Bashkuar.

Me 12 dhjetor 2023, Kolegji i Apelit ka leshur urdhër për paditësin i cili mund të parashtronte përgjigje ndaj ankesës, brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditëve nga dita e pranimit të këtij urdhëri, por paditësi nuk kishte parashtruar përgjigjen në ankesë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjorë, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me 17 tetor 2013 kishte paraqitur kërkesë pranë AL , përmes të cilës kërkoi kompensimin për 11 paga të pa paguara në shumën prej 2,871.00 euro për periudhën korrik 2010 deri në korrik 2012 edhe për, Muajin maj 2013. Me 08 tetor 2014, Autoritetit të Likuidimit (AL) me vendimin GJI105-0150 datës 08 tetor 2014, e kishte pranuar si të bazuar paditësit pagën e muajit maj 2013 në shumë prej 241.23 euro (neto) dhe 32.82 euro në emër të

tatimit të ardhurave personal, ndërsa pjesa tjetër për periudhën e pagave të pa paguara korrik 2010- Korrik 2012 në shumë prej 2,610.00 euro është refuzuara me arsyetim se kërkesa është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar.

Më 07 nëntor 2014, paditësi ka parashtruar pranë DHPGJS-së padi kundër Autoritetit të Likuidimit (AL) GJI105-0150 të datës 08 tetor 2014 me të cilën ishte refuzuar kërkesa kreditore për kompensimin e pagave të pa paguara nga N.T.SH "Sharr" (në Likuidim).

Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-6956, e ka Miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadia e paditësit E Z dhe e ka ndryshuar vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit-Autoritetit të Likuidimit, ashtu që ka detyruar të paditurën Agjencia Kosovare e Privatizimit që paditësit t'ia paguajë shumën prej 2,740.50 euro në emër të kompensimit për 10 paga të mbetura të pa paguara përgjatë periudhës Shtator 2010-Korrik 2012 dhe për një pagë të muajit Maj të vitit 2013, ndërsa pjesën tjetër përtej shumes se aprovuar e ka refuzuar si të pabazuar për shkak të parashkrimit. Ka vendosur shuma e miratuara do të përmbushen në pajtim me prioritet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit dhe që secila pala ti bart shpenzimet e veta.

Kolegji i Apelit i mbështet këto konstatime dhe gjetje faktike të Shkallës së I-rë, se kërkesa e paditësit pjesërisht nuk është parashkruar, kjo ngase paditësi e ka paraqitur kërkesën kreditore pranë AL me datën 17 Tetor 2013, për 11 paga të pa paguara që i referohen periudhës korrik 2010-korrik 2012. Kërkesa kreditore e ka ndërprerë afatin e parashkrimit për tri vjet e fundit, respektivisht për pagat që i takojnë periudhës shtator 2010 e më tutje. Siç ka konstatuar edhe Shkalla e I-rë përjashtimisht paga e muajit korrik 2010, është parashkruar, sepse ajo pagë është parashkruara më së largu në muajin gusht të vitit 2013, respektivisht rreth dy muaj para se të parashtrohej kërkesa kreditore në procedurë të likuidimit andaj ishte i gabuar konstatimi i Autoritetit të Likuidimit se kërkesa e paditësit është e parashkruar për periudhën shtator 2010 e më tutje.

Kolegji i Apelit i ka shqyrtuara dhe vlerësuar pretendimet ankimore të paditurës, mirëpo nuk ka gjetura se ka shkelje, dhe gjithashtu nuk mund të pajtohet me pretendimet e të paditurës se kërkesa e paditësit për paga për periudhën e lartcekur është parashkruar, pasi që të njëjtat nuk janë të argumentuara dhe nuk janë të mbështetura në Ligj.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se me të drejtë Shkalla e I-rë e kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, pasi që ai vendim nuk ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, në shumë prej 100 euro, me datë 12 dhjetor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
